



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2431/ 5 prot

Datë 27.08.2026

V E N D I M
Nr.1059/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Ismail Shehu	Kryetar
Gjergj Mersini	Nënkryetar
Edvin Simo	Anëtar
Donika Daci	Anëtar
Nertil Kanina	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.08.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga BOE “MEGAPHARMA” SHPK & “M E D I C A M E N T A” SHPK & “T R I M E D” SHPK & “LEKLI” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-87713-05-26-2026, me objekt “Lot 133 Human Albumin Serum 20% - 50 ml Flakon.” me fond limit: 185,552,500.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.06.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Përqendruara

Ankimues:

BOE “MEGAPHARMA” SHPK & “M E D I C A M E N T A” SHPK & “T R I M E D” SHPK & “LEKLI” SHPK me NIPT J61814028F, K41420001V, K51612031J, J81624501L dhe adresë: *Rruga e Elbasanit, Mjulle Bathore, Nr.4, perballe TEG , Mjull Bathore, Tiranë*

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqendruara me adresë: *Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)*

Subjekte të Interesuara:

Operatori ekonomik “INTERMED” SHPK me NIPT KJ71424020D dhe adresë: *Rruga “Ismail Qemali” 12/1, Tiranë*

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:**I***Vlerësimi Paraparak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 28.05.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-87713-05-26-2026, me objekt “Lot 133 Human Albumin Serum 20% - 50 ml Flakon.” me fond limit: 185,552,500.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.06.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Pergendruara.

II.2. Në datën 29.06.2026, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 15.07.2026 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave për vlerat pa TVSH si më poshtë:

1. BOE “MEGAPHARMA” SHPK & “M E D I C A M E N T A” SHPK & “T R I M E D” SHPK & “LEKLI” SHPK	121,440,632 lekë	skualifikuar
2. “INTERMED” SHPK	159,181,000 lekë	kualifikuar

II.3.1. BOE “MEGAPHARMA” SHPK & “M E D I C A M E N T A” SHPK & “T R I M E D” SHPK & “LEKLI” SHPK rezulton i skualifikuar për arsyet si më poshtë:

“BOE “M E D I C A M E N T A” shpk & “T R I M E D” shpk & “LEKLI” shpk & “MEGAPHARMA” shpk, me oferte ekonomike: 121,440,632 (njqind e njezete e nje milion e katerqind e dyzete mije e gjashteqind e tridhjetë e dy) Lekë pa TVSH, me dokumentacionin e paraqitur vërteton se nuk i përmbush kërkesat për kualifikim konkretisht: Nga verifikimi i dokumentit "Sigurimi i Ofertës" (Shtojca 4), i dorëzuar në sistem, rezulton se ky sigurim është lëshuar vetëm në emër të operatorëve: “T R I M E D” shpk, “LEKLI” shpk dhe “MEGAPHARMA” shpk. Në tekstin e kësaj garancie mungon plotësisht shoqëria “M E D I C A M E N T A” shpk. Mbështetur në Nenin 88, Pika 2 të VKM-së Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet shprehimisht se përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë duhet të bëjë sigurimin e ofertës, “duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë”, sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi skualifikimin e këtij ofertuesi sepse dokumenti i dorëzuar i Sigurimit të Ofertës (Shtojca 4) përfshin vetëm 3 (tre) nga anëtarët, duke munguar plotësisht shoqëria “M E D I C A M E N T A” shpk.”

II.4. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton, se më datë 27.07.2026 është publikuar njoftimi i fituesit paraprak për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në datën 03.08.2026 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/7114 dhe me nr. 2431/2026 prot., datë 03.08.2026 e BOE “MEGAPHARMA” SHPK & “M E D I C A M E N T A” SHPK & “T R I M E D” SHPK & “LEKLI” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-87713-05-26-2026, me objekt “Lot 133 Human Albumin Serum 20% - 50 ml Flakon.” me fond limit: 185,552,500.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.06.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “MEGAPHARMA” SHPK & “M E D I C A M E N T A” SHPK & “T R I M E D” SHPK & “LEKLI” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit. “

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.2431/1 prot., datë 04.08.2026.

II.7. Përmes shkresës me nr. 4361/28 prot., datë 14.08.2026 me lëndë “Mbi shqyrtimin e ankesës së apra qitur nga Bashkimi i operatorëve ekonomikë “MEGAPHARMA” SHPK & “M E D I C A M E N T A” SHPK & “T R I M E D” SHPK & “LEKLI” SHPK, lidhur me vlerësimin në procedurën e prokurimit me Nr. REF-87713-05-26-2026, me objekt: me objekt “Lot 133 Human Albumin Serum 20% - 50 ml Flakon.” protokolluar me tonën me nr. 2431/2 prot., datë 18.08.2026 autoriteti kontraktor ka dërguar në KPP vendimin për shqyrtimin e ankesës “Vendim K.SH.A 149/2026” datë 14.08.2026 përmes të cili ka vendosur pranimin e plotë të saj duke argumentuar:

“[...]

II.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit të paraqitur në SPE si dhe informacionit të vendosur në dispozicion nga Njësia e Prokurimit:

ARSYETON:

Referuar pretendimit të Bashkimit të Operatorëve ekonomikë ankimues mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e tij me arsyen se: “...Nga verifikimi i dokumentit “Sigurimi i Ofertës” (Shtojca 4), i dorëzuar në sistem, rezulton se ky sigurim është lëshuar vetëm në emër të operatorëve: “T R I M E D” shpk, “LEKLI” shpk dhe “MEGAPHARMA” shpk. Në tekstin e kësaj garancie mungon plotësisht shoqëria “M E D I C A M E N T A” shpk...”, KSHA arsyeton se:

Në Dokumentet e Tenderit të publikuara për procedurën e prokurimit objekt ankimimi, është përcaktuar:

Seksioni 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike

3.1 Sigurimi i ofertës: (e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se se prokurimi me vlerë të vogël).

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor, në bazë të diskrecionit të tij, mund të kërkojë sigurimin e ofertës edhe për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 4.

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është 117,927,031 (njëqind e shtatëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e njëzet e shtatë mijë e tridhjetë e një) lekë ose 1,235,614 (një milion e dyqind e tridhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e katërmëdhjetë) euro.

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

Loti	Principi aktiv	Formedoza	Njesia	Vlera e sigurimit të ofertës (Lekë)	Vlera e sigurimit të ofertës (Euro)
Lot 133	Human Albumin Serum	20% - 50 ml	Flakon	3,711,050	38,884

3.1.2 Autoriteti/Enti kontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor _____ (të shënohet numri i llogarisë bankare të autoritetit ose entit kontraktor)

Nr.	Banka	Nr. llogarise
1	Credins	AL91 2121 1009 0000 0000 0203 2030

3.1.3 Autoriteti/Enti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:

- i. garancisë bankare X
ose
- ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente X

3.2 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë

Në Dokumentet e Tenderit, Shtojca 4 "FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS" është përcaktuar:

"(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]
FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]
Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]
* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]
Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]
Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.
* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,
Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]"

Në Nenin 2 "Qëllimi" të Ligjit Nr. 162/2021 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), parashikohet se: "Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik."

Në Nenin 3 "Parime të përgjithshme" të LPP-së Nr. 162/2021 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), parashikohet se:

"1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën."

Në Nenin 21 "Autoriteti ose enti kontraktor", pika 1 të Ligjit Nr. 162/2021 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), parashikohet se:

"1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi."

Në Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), parashikohet se:

"1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 41, pika 4, parashikohet se:

“4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- c) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.
- d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë. ”.

Në nenin 83 “Sigurimi i Ofertës” të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), përcaktohet:

1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës:

i. në formën e garancisë bankare; ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente.

3. Autoriteti ose enti kontraktor konfiskon sigurimin e ofertës në rast të:

a) tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave;

b) refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit.

c) mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimin të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

4. Autoriteti ose enti kontraktor nuk e pretendon vlerën e sigurimit të ofertës dhe kthen menjëherë mbrapsht dokumentin e sigurimit të ofertës, nëse:

a) ka përfunduar afati kohor i sigurimit të ofertës;

b) është lidhur kontrata dhe është paraqitur sigurimi i kontratës, kur një gjë e tillë kërkohet

nga dokumentet e tenderit;

c) janë anuluar procedurat e tenderit pa shpallur fitues.

5. Autoriteti ose enti kontraktor raporton përmes Sistemit të Prokurimit Elektronik pranë Agjencisë së Prokurimit Publik rastet e refuzimit të operatorit ekonomik për nënshkrimin e kontratës, sipas shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni.

6. Kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk nënshkruan kontratën, autoriteti kontraktor bën konfiskimin e sigurimit të ofertës.

Në rastin kur është përdorur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese "oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim" dhe kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur, vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe të dytë është jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës të ofertuesit që është tërhequr.

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), Neni 88 "Bashkimi i operatorëve ekonomikë", pika 2, parashikohet se:

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

KSHA vlerëson se çështja juridike që kërkon vlerësim nuk është thjesht nëse emri i anëtarit "MEDICAMENTA" shpk është shënuar apo jo në Formularin e Sigurimit të Ofertës. Ky është një fakt i pakontestueshëm, pasi në policën nr. serial 060015920060131 figurojnë operatorët ekonomikë: "MEGAPHARMA" shpk, "LEKLI" shpk dhe "TRIMED" shpk, ndërsa "MEDICAMENTA" shpk nuk është pasqyruar. Çështja që duhet vlerësuar është nëse kjo mungesë është një mosplotësim material i detyrimit për sigurimin e ofertës, apo një pasaktësi materiale në pasqyrimin dokumentar të një garancie që ishte kërkuar dhe juridikisht krijuar për të gjithë BOE-në përpara përfundimit të afatit të ofertimit. KSHA vlerëson se polica nuk mund të shqyrtohet e shpëputur nga dokumentet e tjera që provojnë gjendjen faktike dhe juridike në momentin e ofertimit, konkretisht:

Referuar kontratës së bashkëpunimit të datës 27.06.2026 rezulton se për Lotin 133 ishte krijuar bashkimi i përkohshëm ndërmjet "MEGAPHARMA" shpk, "LEKLI" shpk, "TRIMED" shpk dhe "MEDICAMENTA" shpk, me pjesëmarrje të secilit operator në masën 25%. Në të njëjtin akt rezulton se operatorët e tjerë kanë autorizuar operatorin "MEGAPHARMA" shpk për përfaqësimin e tyre në procedurë, përfshirë shprehimisht Lotin 133. KSHA vlerëson se këto dokumente provojnë se identiteti juridik i ofertuesit në datën e ofertimit ka qenë një BOE me katër anëtarë dhe se përfaqësuesi i tij ka qenë operatori "MEGAPHARMA" shpk. Nuk ekziston asnjë provë se përbërja

e BOE-së është modifikuar pas afatit apo se operatori ekonomik “MEDICAMENTA” është shtuar më vonë.

Akoma më tej, KSHA duke shqyrtuar vetë policën e Lotit 133, nr. serial 060015920060131, konstaton se pavarësisht mosshënimit të “MEDICAMENTA”, polica identifikon saktë autoritetin kontraktor, identifikon numrin e referencës së procedurës së prokurimit REF-87713-05-26-2026, identifikon saktë Lotin 133 “Human Albumin Serum 20% – 50 ml”, përcakton shumën e plotë të sigurimit prej 3,711,050 lekësh, përfshin përfaqësuesin/kryesuesin e BOE-së “MEGAPHARMA”, përcakton rastet e ekzekutimit të sigurimit dhe mban afatin e kërkuar të vlefshmërisë. Pra, mangësia e evidentuar nuk lidhet me objektin e sigurimit, shumën e tij, procedurën, përfituesin, afatin apo kushtet e ekzekutimit, por lidhet vetëm me mospasqyrimin e njërit prej emrave të anëtarëve të bashkimit të operatorëve. KSHA vlerëson se kjo situatë duhet interpretuar në raport me nenin 88 pika 2 të VKM-së nr. 285/2021, ku kjo dispozitë kërkon që, në rastin e një bashkimi operatorësh ekonomikë, përfaqësuesi të kryejë sigurimin e ofertës duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkim. Kërkesa synon që oferta e BOE-së të jetë realisht e garantuar dhe që autoriteti kontraktor të mos mbetet pa mbrojtje në rast të verifikimit të kushteve të ekzekutimit të garancisë. KSHA gjykon se kjo kërkesë është e detyrueshme dhe nuk mund të relativizohet, por interpretimi i saj nuk mund të shkëputet nga efekti konkret juridik i mangësisë. Nëse siguri do të ishte kërkuar që në origjinë vetëm për tre operatorë dhe pas përfundimit të afatit BOE do të kërkonte përfshirjen e operatorit të katërt, atëherë do të kishim një ndryshim substancial të ofertës dhe të garancisë, i cili nuk mund të korrigjohej nëpërmjet një sqarimi.

Referuar shkresës nr. 579 prot., datë 16.07.2026, të shoqërisë së sigurimit “ATLANTIK” sh.a., vënë në dispozicion nga ankimuesi në ankesën e tij, konstatohet se, siguruesi nuk kufizohet në një deklaram të përgjithshëm se ka ndodhur një gabim, por ai referon kërkesën e bërë më 26.06.2026 dhe konfirmon se për Lotet 126 dhe 133 siguri ishte kërkuar për BOE-në e përbërë nga operatorët ekonomikë “Megapharma” shpk, “Lekli” shpk, “Trimed” shpk dhe “Medicamenta” shpk. Siguruesi deklaron se mosvendosja e operatorit “Medicamenta” shpk në policën e Lotit 133 ka ardhur *“për shkak të një gabimi teknik të operatorit të shoqërisë së sigurimit”*. Gjithashtu, po në këtë shkresë kompania e sigurimit “ATLANTIK” sh.a. konfirmon se gabimi teknik *“nuk çënon vlefshmërinë e policës”*, dhe se *“garancia mbetet e vlefshme dhe e ekzekutueshme për të gjithë bashkimin e operatorëve ekonomikë të përfaqësuar nga “Megapharma” shpk, përfshirë edhe shoqërinë “MEDICAMENTA” shpk, pa çënuar angazhimin financiar dhe ligjor të siguruesit”*. KSHA çmon se ky deklaram duhet vlerësuar së bashku me dokumentin e datës 26.06.2026 dhe jo i izoluar prej tij. Vërtet shkresa e siguruesit mban datën 16.07.2026 dhe për rrjedhojë është hartuar pas afatit të ofertimit, por data e një dokumenti sqarues nuk është në vetvete kriteri vendimtar për të përcaktuar nëse kemi plotësim të palejuar të ofertës. Kriteri vendimtar është çfarë fakti juridik provon dokumenti dhe në cilin moment ekzistonte ai fakt. Në rastin konkret, shkresa e datës 16.07.2026 nuk krijon për herë të parë kërkesën për sigurimin e operatorit “MEDICAMENTA” shpk, por kjo kërkesë provohet më 26.06.2026, nuk krijon për herë të parë BOE-në me katër operatorë - kjo provohet nga kontrata dhe prokura e datës 27.06.2026, nuk ndryshon shumën e sigurimit, nuk ndryshon lotin, nuk ndryshon përfituesin, nuk zgjat afatin, nuk krijon një policë të

re, por shërben për të sqaruar natyrën e një pasaktësie të ndodhur në dokumentin e lëshuar përpara ofertimit dhe për të konfirmuar efektin juridik të marrëdhënies së sigurimit në momentin e krijimit të saj. Në këtë pikë merr rëndësi neni 92 i LPP-së, ku dispozita lejon që gjatë shqyrtimit të ofertës të bëhet dallimi midis devijimeve materiale dhe devijimeve të vogla, gabimeve të korrigjueshme dhe informacioneve që mund të verifikohen nga dokumente faktike që pasqyrojnë gjendjen e operatorit në momentin e ofertimit.

KSHA vlerëson se sqarimi i rastit konkret nuk ndryshon përmbajtjen e ofertës, pasi:

- nuk ndryshon identitetin e ofertuesit;
- nuk shton një operator ekonomik të ri në BOE;
- nuk ndryshon përqindjet e pjesëmarrjes;
- nuk ndryshon vlerën e ofertës;
- nuk ndryshon objektin apo kushtet teknike;
- nuk krijon një sigurim të ri pas afatit;
- nuk shton një detyrim financiar të garantuesit që nuk ekzistonte më parë.

Dokumentacioni i datës 26.06.2026 provon se vullneti për sigurimin e BOE-së me katër anëtarë ishte i formuar dhe i komunikuar tek siguroesi përpara ofertimit, ndërsa siguroesi “ATLANTIK” sh.a. merr përsipër shprehimisht se angazhimi i saj financiar ka mbuluar të gjithë bashkimin. Në këto kushte, mospasqyrimi i emrit të operatorit ekonomik “MEDICAMENTA” shpk në policën e printuar duhet vlerësuar jo si mungesë e sigurimit të ofertës, por si pasaktësi materiale në materializimin dokumentar të një garancie ekzistuese. Ky interpretim është në përputhje jo vetëm me nenin 92 të LPP-së dhe nenin 88 të RRPP-së të interpretuara në mënyrë të harmonizuar, por edhe me parimet themelore të prokurimit publik. Formaliteti në prokurimin publik është instrument për garantimin e barazisë, sigurisë juridike dhe transparencës dhe nuk mund të shndërrohet në qëllim në vetvete kur prova objektive tregojnë se interesi juridik që norma synon të mbrojë nuk është cënuar. Në rastin konkret autoriteti kontraktor disponon një sigurim për shumën e plotë, për procedurën e saktë, numrin e Referencës dhe Lotin 133, si dhe garantuesi konfirmon se garancia është e ekzekutueshme për të gjithë ofertën e bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Për sa më sipër, KSHA arrin në përfundimin se nga vlerësimi i:

- kërkesës së datës 26.06.2026 drejtuar shoqërisë siguroese “ATLANTIK” sh.a.;
- kontratës së bashkëpunimit dhe prokurës së posaçme të datës 27.06.2026;
- policës së Lotit 126 të lëshuar për BOE x4;
- policës së Lotit 133 me shumën dhe objektin e saktë të prokurimit dhe numrin e Referencës;
- shkresës sqaruese nr. 579 prot., datë 16.07.2026 të siguroesit “ATLANTIK” sh.a.;
- dokumentacionit të vetë procesit të vlerësimit;

rezulton se sigurimi i ofertës për Lotin 133 është kërkuar përpara datës së hapjes së ofertave për bashkimin me katër operatorë ekonomikë dhe angazhimi financiar i siguroesit ka pasur si objekt ofertën e këtij bashkimi. Mosshënimi i operatorit “MEDICAMENTA” shpk në formular është pasojë e një gabimi teknik në hartimin e dokumentit dhe jo mungesë substanciale e sigurimit të

ofertës. Në këtë kuptim, marrja në konsideratë e dokumenteve sqaruese nuk përbën lejim për plotësimin pas afatit të një kriteri të papërbushur, por verifikim të një fakti juridik ekzistues në kohën e ofertimit.

Në të njëjtën kohë, KSHA çmon se mënyra procedurale e ndjekur nga KVO, kalimi në shqyrtimin e ofertës anomalisht të ulët, pa zgjidhur më parë një problematikë dokumentare të dukshme që në ofertë, dhe moskryerja e verifikimit të nevojshëm pranë shoqërisë së sigurimit përpara skualifikimit, ka prodhuar një proces vlerësimi të paplotë dhe jo mjaftueshmërisht koherent. Kjo problematikë nuk përbën e vetme bazë për kualifikimin e ofertës, por e vlerësuar së bashku me provat materiale të sipëranalizuara, përforcon konkluzionin se skualifikimi është mbështetur në një interpretim formal dhe jo në vlerësimin e efektit real juridik të sigurimit të ofertës.

Për sa më sipër, pretendimi i Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë ankimues qëndron.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në Nenin 114 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), si dhe Nenit 102 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), Komisioni i ngarkuar për Shqyrtimin e Ankesave,

VENDOSI

1. Pranimin e plotë të ankesës së paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “MEGAPHARMA” SHPK & “MEDICAMENTA” SHPK & “TRIMED” SHPK & “LEKLI” SHPK.
2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
4. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.
5. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.

II.8. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ nuk rezulton të jenë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara në kuptim të nenit 113 *te lex specialis* në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e BOE “MEGAPHARMA” SHPK & “M E D I C A M E N T A” SHPK & “T R I M E D” SHPK & “LEKLI” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për skualifikimin e ofertës së tyre në procedurën e prokurimit objekt ankimi,, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Përmes shkresës me nr. 4361/28 prot., datë 14.08.2026 me lëndë “Mbi shqyrtimin e ankesës së apraqitur nga Bashkimi i operatorëve ekonomikë “MEGAPHARMA” SHPK & “M E D I C A M E N T A” SHPK & “T R I M E D” SHPK & “LEKLI” SHPK, lidhur me vlerësimin në procedurën e prokurimit me Nr. REF-87713-05-26-2026, me objekt: me objekt “Lot 133 Human Albumin Serum 20% - 50 ml Flakon.” protokolluar me tonën me nr. 2431/2 prot., datë 18.08.2026 autoriteti kontraktor ka dërguar në KPP vendimin për shqyrtimin e ankesës “Vendim K.SH.A 149/2026” datë 14.08.2026 përmes të cili ka vendosur pranimin e plotë të saj duke argumentuar:

“[...]

II.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit të paraqitur në SPE si dhe informacionit të vendosur në dispozicion nga Njësia e Prokurimit:

ARSYETON:

Referuar pretendimit të Bashkimit të Operatorëve ekonomikë ankimues mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e tij me arsyen se: “...Nga verifikimi i dokumentit “Sigurimi i Ofertës” (Shtojca 4), i dorëzuar në sistem, rezulton se ky sigurim është lëshuar vetëm në emër të operatorëve: “T R I M E D” shpk, “LEKLI” shpk dhe “MEGAPHARMA” shpk. Në tekstin e kësaj garancie mungon plotësisht shoqëria “M E D I C A M E N T A” shpk...”, KSHA arsyeton se:

Në Dokumentet e Tenderit të publikuara për procedurën e prokurimit objekt ankimimi, është përcaktuar:

Seksioni 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike

3.1 Sigurimi i ofertës: (e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se se prokurimi me vlerë të vogël).

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor, në bazë të diskrecionit të tij, mund të kërkojë sigurimin e ofertës edhe për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 4.

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është 117,927,031 (njëqind e shtatëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e njëzet e shtatë mijë e tridhjetë e një) lekë ose 1,235,614 (një milion e dyqind e tridhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e katërmëdhjetë) euro.

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

Loti	Principi aktiv	Formedoza	Njesia	Vlera e sigurimit të ofertës (Lekë)	Vlera e sigurimit të ofertës (Euro)
Lot 133	Human Albumin Serum	20% - 50 ml	Flakon	3,711,050	38,884

3.1.2 Autoriteti/Enti kontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor _____ (të shënohet numri i llogarisë bankare të autoritetit ose entit kontraktor)

Nr.	Banka	Nr. llogarise
1	Credins	AL91 2121 1009 0000 0000 0203 2030

3.1.3 Autoriteti/Enti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:

- i. garancisë bankare *X*
ose
- ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente *X*

3.2 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë

Në Dokumentet e Tenderit, Shtojca 4 "FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS" është përcaktuar:

"(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]
FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]"

Në Nenin 2 "Qëllimi" të Ligjit Nr. 162/2021 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), parashikohet se: "Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik."

Në Nenin 3 "Parime të përgjithshme" të LPP-së Nr. 162/2021 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), parashikohet se:

"1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën."

Në Nenin 21 "Autoriteti ose enti kontraktor", pika 1 të Ligjit Nr. 162/2021 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), parashikohet se:

"1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi."

Në Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), parashikohet se:

"1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 41, pika 4, parashikohet se:

“4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- c) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.
- d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.”.

Në nenin 83 “Sigurimi i Ofertës” të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), përcaktohet:

1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës:

i. në formën e garancisë bankare; ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente.

3. Autoriteti ose enti kontraktor konfiskon sigurimin e ofertës në rast të:

a) tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave;

b) refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit.

c) mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimin të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

4. Autoriteti ose enti kontraktor nuk e pretendon vlerën e sigurimit të ofertës dhe kthen menjëherë mbrapsht dokumentin e sigurimit të ofertës, nëse:

a) ka përfunduar afati kohor i sigurimit të ofertës;

b) është lidhur kontrata dhe është paraqitur sigurimi i kontratës, kur një gjë e tillë kërkohet

nga dokumentet e tenderit;

c) janë anuluar procedurat e tenderit pa shpallur fitues.

5. Autoriteti ose enti kontraktor raporton përmes Sistemit të Prokurimit Elektronik pranë Agjencisë së Prokurimit Publik rastet e refuzimit të operatorit ekonomik për nënshkrimin e kontratës, sipas shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni.

6. Kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk nënshkruan kontratën, autoriteti kontraktor bën konfiskimin e sigurimit të ofertës.

Në rastin kur është përdorur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese "oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim" dhe kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor për zgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të për zgjedhura që kanë mbetur, vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe të dytë është jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës të ofertuesit që është tërhequr.

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), Neni 88 "Bashkimi i operatorëve ekonomikë", pika 2, parashikohet se:

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

KSHA vlerëson se çështja juridike që kërkon vlerësim nuk është thjesht nëse emri i anëtarit "MEDICAMENTA" shpk është shënuar apo jo në Formularin e Sigurimit të Ofertës. Ky është një fakt i pakontestueshëm, pasi në policën nr. serial 060015920060131 figurojnë operatorët ekonomikë: "MEGAPHARMA" shpk, "LEKLI" shpk dhe "TRIMED" shpk, ndërsa "MEDICAMENTA" shpk nuk është pasqyruar. Çështja që duhet vlerësuar është nëse kjo mungesë është një mosplotësim material i detyrimit për sigurimin e ofertës, apo një pasaktësi materiale në pasqyrimin dokumentar të një garancie që ishte kërkuar dhe juridikisht krijuar për të gjithë BOE-në përpara përfundimit të afatit të ofertimit. KSHA vlerëson se polica nuk mund të shqyrtohet e shpëputur nga dokumentet e tjera që provojnë gjendjen faktike dhe juridike në momentin e ofertimit, konkretisht:

Referuar kontratës së bashkëpunimit të datës 27.06.2026 rezulton se për Lotin 133 ishte krijuar bashkimi i përkohshëm ndërmjet "MEGAPHARMA" shpk, "LEKLI" shpk, "TRIMED" shpk dhe "MEDICAMENTA" shpk, me pjesëmarrje të secilit operator në masën 25%. Në të njëjtin akt rezulton se operatorët e tjerë kanë autorizuar operatorin "MEGAPHARMA" shpk për përfaqësimin e tyre në procedurë, përfshirë shprehimisht Lotin 133. KSHA vlerëson se këto dokumente provojnë se identiteti juridik i ofertuesit në datën e ofertimit ka qenë një BOE me katër anëtarë dhe se përfaqësuesi i tij ka qenë operatori "MEGAPHARMA" shpk. Nuk ekziston asnjë provë se përbërja

e BOE-së është modifikuar pas afatit apo se operatori ekonomik “MEDICAMENTA” është shtuar më vonë.

Akoma më tej, KSHA duke shqyrtuar vetë policën e Lotit 133, nr. serial 060015920060131, konstaton se pavarësisht mosshënimit të “MEDICAMENTA”, polica identifikon saktë autoritetin kontraktor, identifikon numrin e referencës së procedurës së prokurimit REF-87713-05-26-2026, identifikon saktë Lotin 133 “Human Albumin Serum 20% – 50 ml”, përcakton shumën e plotë të sigurimit prej 3,711,050 lekësh, përfshin përfaqësuesin/kryesuesin e BOE-së “MEGAPHARMA”, përcakton rastet e ekzekutimit të sigurimit dhe mban afatin e kërkuar të vlefshmërisë. Pra, mangësia e evidentuar nuk lidhet me objektin e sigurimit, shumën e tij, procedurën, përfituesin, afatin apo kushtet e ekzekutimit, por lidhet vetëm me mospasqyrimin e njërit prej emrave të anëtarëve të bashkimit të operatorëve. KSHA vlerëson se kjo situatë duhet interpretuar në raport me nenin 88 pika 2 të VKM-së nr. 285/2021, ku kjo dispozitë kërkon që, në rastin e një bashkimi operatorësh ekonomikë, përfaqësuesi të kryejë sigurimin e ofertës duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkim. Kërkesa synon që oferta e BOE-së të jetë realisht e garantuar dhe që autoriteti kontraktor të mos mbetet pa mbrojtje në rast të verifikimit të kushteve të ekzekutimit të garancisë. KSHA gjykon se kjo kërkesë është e detyrueshme dhe nuk mund të relativizohet, por interpretimi i saj nuk mund të shpëputet nga efekti konkret juridik i mangësisë. Nëse siguri do të ishte kërkuar që në origjinë vetëm për tre operatorë dhe pas përfundimit të afatit BOE do të kërkonte përfshirjen e operatorit të katërt, atëherë do të kishim një ndryshim substancial të ofertës dhe të garancisë, i cili nuk mund të korrigjohet nëpërmjet një sqarimi.

Referuar shkresës nr. 579 prot., datë 16.07.2026, të shoqërisë së sigurimit “ATLANTIK” sh.a., vënë në dispozicion nga ankimuesi në ankesën e tij, konstatohet se, siguruesi nuk kufizohet në një deklaram të përgjithshëm se ka ndodhur një gabim, por ai referon kërkesën e bërë më 26.06.2026 dhe konfirmon se për Lotet 126 dhe 133 siguri ishte kërkuar për BOE-në e përbërë nga operatorët ekonomikë “Megapharma” shpk, “Lekli” shpk, “Trimed” shpk dhe “Medicamenta” shpk. Siguruesi deklaron se mosvendosja e operatorit “Medicamenta” shpk në policën e Lotit 133 ka ardhur *“për shkak të një gabimi teknik të operatorit të shoqërisë së sigurimit”*. Gjithashtu, po në këtë shkresë kompania e sigurimit “ATLANTIK” sh.a. konfirmon se gabimi teknik *“nuk çënon vlefshmërinë e policës”*, dhe se *“garancia mbetet e vlefshme dhe e ekzekutueshme për të gjithë bashkimin e operatorëve ekonomikë të përfaqësuar nga “Megapharma” shpk, përfshirë edhe shoqërinë “MEDICAMENTA” shpk, pa çënuar angazhimin financiar dhe ligjor të siguruesit”*. KSHA çmon se ky deklaram duhet vlerësuar së bashku me dokumentin e datës 26.06.2026 dhe jo i izoluar prej tij. Vërtet shkresa e siguruesit mban datën 16.07.2026 dhe për rrjedhojë është hartuar pas afatit të ofertimit, por data e një dokumenti sqarues nuk është në vetvete kriteri vendimtar për të përcaktuar nëse kemi plotësim të palejuar të ofertës. Kriteri vendimtar është çfarë fakti juridik provon dokumenti dhe në cilin moment ekzistonte ai fakt. Në rastin konkret, shkresa e datës 16.07.2026 nuk krijon për herë të parë kërkesën për sigurimin e operatorit “MEDICAMENTA” shpk, por kjo kërkesë provohet më 26.06.2026, nuk krijon për herë të parë BOE-në me katër operatorë - kjo provohet nga kontrata dhe prokura e datës 27.06.2026, nuk ndryshon shumën e sigurimit, nuk ndryshon lotin, nuk ndryshon përfituesin, nuk zgjat afatin, nuk krijon një policë të

re, por shërben për të sqaruar natyrën e një pasaktësie të ndodhur në dokumentin e lëshuar përpara ofertimit dhe për të konfirmuar efektin juridik të marrëdhënies së sigurimit në momentin e krijimit të saj. Në këtë pikë merr rëndësi neni 92 i LPP-së, ku dispozita lejon që gjatë shqyrtimit të ofertës të bëhet dallimi midis devijimeve materiale dhe devijimeve të vogla, gabimeve të korrigjueshme dhe informacioneve që mund të verifikohen nga dokumente faktike që pasqyrojnë gjendjen e operatorit në momentin e ofertimit.

KSHA vlerëson se sqarimi i rastit konkret nuk ndryshon përmbajtjen e ofertës, pasi:

- nuk ndryshon identitetin e ofertuesit;
- nuk shton një operator ekonomik të ri në BOE;
- nuk ndryshon përqindjet e pjesëmarrjes;
- nuk ndryshon vlerën e ofertës;
- nuk ndryshon objektin apo kushtet teknike;
- nuk krijon një sigurim të ri pas afatit;
- nuk shton një detyrim financiar të garantuesit që nuk ekzistonte më parë.

Dokumentacioni i datës 26.06.2026 provon se vullneti për sigurimin e BOE-së me katër anëtarë ishte i formuar dhe i komunikuar tek siguruesi përpara ofertimit, ndërsa siguruesi “ATLANTIK” sh.a. merr përsipër shprehimisht se angazhimi i saj financiar ka mbuluar të gjithë bashkimin. Në këto kushte, mospasqyrimi i emrit të operatorit ekonomik “MEDICAMENTA” shpk në policën e printuar duhet vlerësuar jo si mungesë e sigurimit të ofertës, por si pasaktësi materiale në materializimin dokumentar të një garancie ekzistuese. Ky interpretim është në përputhje jo vetëm me nenin 92 të LPP-së dhe nenin 88 të RRPP-së të interpretuara në mënyrë të harmonizuar, por edhe me parimet themelore të prokurimit publik. Formaliteti në prokurimin publik është instrument për garantimin e barazisë, sigurisë juridike dhe transparencës dhe nuk mund të shndërrohet në qëllim në vetvete kur prova objektive tregojnë se interesi juridik që norma synon të mbrojë nuk është cënuar. Në rastin konkret autoriteti kontraktor disponon një sigurim për shumën e plotë, për procedurën e saktë, numrin e Referencës dhe Lotin 133, si dhe garantuesi konfirmon se garancia është e ekzekutueshme për të gjithë ofertën e bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Për sa më sipër, KSHA arrin në përfundimin se nga vlerësimi i:

- kërkesës së datës 26.06.2026 drejtuar shoqërisë siguruese “ATLANTIK” sh.a.;
- kontratës së bashkëpunimit dhe prokurës së posaçme të datës 27.06.2026;
- policës së Lotit 126 të lëshuar për BOE x4;
- policës së Lotit 133 me shumën dhe objektin e saktë të prokurimit dhe numrin e Referencës;
- shkresës sqaruese nr. 579 prot., datë 16.07.2026 të siguruesit “ATLANTIK” sh.a.;
- dokumentacionit të vetë procesit të vlerësimit;

rezulton se sigurimi i ofertës për Lotin 133 është kërkuar përpara datës së hapjes së ofertave për bashkimin me katër operatorë ekonomikë dhe angazhimi financiar i siguruesit ka pasur si objekt ofertën e këtij bashkimi. Mosshënimi i operatorit “MEDICAMENTA” shpk në formular është pasojë e një gabimi teknik në hartimin e dokumentit dhe jo mungesë substanciale e sigurimit të

ofertës. Në këtë kuptim, marrja në konsideratë e dokumenteve sqaruese nuk përbën lejim për plotësimin pas afatit të një kriteri të papërbushur, por verifikim të një fakti juridik ekzistues në kohën e ofertimit.

Në të njëjtën kohë, KSHA çmon se mënyra procedurale e ndjekur nga KVO, kalimi në shqyrtimin e ofertës anomalisht të ulët, pa zgjidhur më parë një problematikë dokumentare të dukshme që në ofertë, dhe moskryerja e verifikimit të nevojshëm pranë shoqërisë së sigurimit përpara skualifikimit, ka prodhuar një proces vlerësimi të paplotë dhe jo mjaftueshmërisht koherent. Kjo problematikë nuk përbën e vetme bazë për kualifikimin e ofertës, por e vlerësuar së bashku me provat materiale të sipëranalizuara, përforcon konkluzionin se skualifikimi është mbështetur në një interpretim formal dhe jo në vlerësimin e efektit real juridik të sigurimit të ofertës.

Për sa më sipër, pretendimi i Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë ankimues qëndron.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në Nenin 114 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), si dhe Nenit 102 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), Komisioni i ngarkuar për Shqyrtimin e Ankesave,

VENDOSI

1. Pranimin e plotë të ankesës së paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “MEGAPHARMA” SHPK & “MEDICAMENTA” SHPK & “TRIMED” SHPK & “LEKLI” SHPK.
2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
4. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.
5. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.

III.1.2. Neni 30 i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon se: *“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera”.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikon se: “1.Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/ klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.”

III.1.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ duke qenë se KSHA e autoritetit kontraktor ka pranuar plotësisht ankesën e BOE ankimes si dhe nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara në përputhje me parashikimet e nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, KPP bazuar në nenin 115 të ligjit të sipërcituar do të mbyllë çështjen për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30, 115 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga BOE “MEGAPHARMA” SHPK & “M E D I C A M E N T A” SHPK & “T R I M E D” SHPK & “LEKLI” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-87713-05-26-2026, me objekt “Lot 133 Human Albumin Serum 20% - 50 ml Flakon.” me fond limit: 185,552,500.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.06.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.

2. Autoriteti kontraktor të zbatojë vendimin e KSHA-së me nr. 149/2026 datë 14.08.2026 të dërguar në KPP përmes shkresës me nr. 4361/28 prot., datë 14.08.2026 protokolluar me tonën me nr. 2431/2 prot., datë 18.08.2026.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë KPP mbi zbatimin e vendimit të KSHA duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “MEGAPHARMA” SHPK & “M E D I C A M E N T A” SHPK & “T R I M E D” SHPK & “LEKLI” SHPK.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Gjergj Mersini

Anëtar
Edvin Simo

Anëtar
Donika Daci

Anëtar
Nertil Kanina

Kryetar
Ismail Shehu

